



N.SH.T. "MIRANDA"
Nr. i biznesit 70713845
Pronar – Ramë IDRIZAJ
OK "N.SH.T. Miranda"
Banjë
Istogë

Ref: 1505/576/LIC/ni

Vendim

për licencimin e Operatorit Kabllor, "N.SH.T. Miranda" me seli në Banjë, në Komunën e Istogut

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Kandidati "N.SH.T. Miranda" ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë kabllorë, më datën 6 maj 2015.

Arsyetim

3. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *"për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja"*.
5. KPM, kandidatit për licencë për operator kabllor "N.SH.T. Miranda" i ka përcjellë përmesë e-maili, perveq rregulloreve relevante të KPM-së për aplikim për licencë si: Rregulloren e KPM-së për Dhënie e Licencës (KPM-2013/04), Rregulloren për Nivelin

1/2

dhe Mënyren e Pagesës së Tarifës për Licencë (KPM-2014/03), Rregullores për Distribuimin Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC-2007/04) dhe Formën për aplikim për licencë për operator kabllor.


6. Komisioni vlerëson se, kandidati “N.SH.T. Miranda” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor, në pajtueshmëri me Nenin 7 të Rregullores CIMC 2007/04.
7. Me Rregulloren CIMC 2007/04 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor. Prandaj, Komisioni vlerëson se, një operator kabllor mund të licençohet edhe me një numër minimal të programeve, ndërsa kandidati “N.SH.T. Miranda” ka dorëzuar një listë prej 35 kanaleve.
8. Kandidati për operator kabllor “N.SH.T. Miranda” do të ketë të drejtë të bart, në pakon e tij programore, vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit për bartjen e kanaleve përmes rrjetit kabllor.
9. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator kabllor “N.SH.T. Miranda” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në rrjetin e tij kabllor, dhe mund të zgjerojë listën e programeve në të ardhmen. Kandidati “N.SH.T. Miranda” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
10. Komisioni, vlerëson se “N.SH.T. Miranda” ka paraqitur aplikacionin në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me Rregulloren e KPM-së KPM-2013/04.
11. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor “N.SH.T. Miranda” ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së.

Vendim

12. Në takimin e mbajtur më datën 26 maj 2015, Komisioni merr vendim që, kandidatit “N.SH.T. Miranda” i cili planifikon të operojë në fshatin Banjë të Komunës së Istogut, t’i lëshojë licencën e KPM-së për operator kabllorë, për të ofruar shërbime të programeve përmes operatorit kabllorë, për të cilat posedon marrëveshje valide për transmetim përmes sistemit kabllor.

Lëshimi i Vendimit

13. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. Kandidati mund të fillojë veprimtarinë e tij si operatorë kabllorë vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



02.06.2015
datë

2/2

576

Lloji i dërgesës
Vrsta pošiljke

Vlera e cekur - Shuma e dërguar
Oznaçona vrednost - poslani iznos

nën numër
pod br.

për
za

N.SH.T MIRANDA-RANE IDRIZAJ
BANORA PEÇES - KOMUNA ISTOG

(Vendi)
(Mesto)

Poshtë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (pëgjar me datë)
Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka (poslani iznos) predata uredno (placena dana)

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca

- Idrizaj

(OIRA)

Vula e postës së vendit
Peçat poste



Nënshkrimi i nënpunësit
të postës së vendit
Potpis radnika poste

Idrizaj